REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

# R R E G U L L O R E TIP

Nr. 1492 Date 21 . 06.2001

## Per Sherbimin e Ruajtjes dhe Sigurise Fizike te Shoqerive Private te Ruajtjes (SH.P.R.).

Ne zbatim te nenit 119 pika 1 te Kushtetutes, ligjit Nr.8770 date 19.04.2001" Per Sherbimin e Ruajtjes dhe Sigurise Fizike, neni 6, me qellim percaktimin e rregullave te sherbimit dhe marrjes se masave tekniko administrative per ruajtjen dhe sigurimin e objekteve publike dhe private ne pronesi ose ne perdorim te personave juridike a fizike, shqipetar ose te huaj si dhe mbrojtjen e jetes se personave, ruajtjen dhe sigurimin e vlerave monetare e materiale ose te sendeve te çmuara gjate levizjes. Ministri i Rendit Publik, nxjerr kete rregullore;

### K R E U I-re

### Rregulla te Pergjithshme

1.Ruajtja dhe sigurimi i objekteve publike dhe private, mbrojtja e jetes dhe shendetit personal te shtetasve shqipetar ose te huaj, shoqerimi i vlerave monetare e materiale ose i sendeve te çmuara gjate transportit behet nga SH.P.R. te liçensuara per kete qellim.

monetare e materiale ose sendeve te çmuara gjate transportit te tyre organizon sherbim me

- Roje fikse ose levizese
- Grup te gatshem
- Me qen sherbim (me çertifikate)
- Me sisteme audiovizive

Per kryerjen e sherbimit perdorin mjete transporti me emblemen e shoqerise

10.Punonjesi i sherbimit te shoqerise te ruajtjes dhe te sigurise fizike, kryen sherbim me armatim ose pa armatim sipas llojit dhe natyres se sherbimit si dhe me uniforme te miratuar me urdher te Ministrit te Rendit Publik.

11.Transportimi dhe levizja e vlerave monetare, materiale dhe sende te çmuara behet me mjete te blinduara nga SH.P.R. e liçensuar per kete qellim.

12.Shoqerimi i vlerave monetare e materiale apo sendeve te çmuara behet me punonjes sherbimi te shoqerise te paisur me mjete speciale mbrojtese. Transportimi i punonjesve te sherbimit behet me mjete te pershtatshme transporti per kete sherbim.

13.Per çdo objekt te marre ne ruajtje, drejtuesi teknik pergatit plan disllokimin e sherbimit se bashku me skemen e ruajtjes.

14.Planifikimi i punonjesve te sherbimit te shoqerise behet ne librin e sherbimit, qe permban :

- Planizimin e sherbimit per çdo punonjes
- Detyrat e dhena
- Kontrolli i kryerjes se sherbimit

15.Koha e kryerjes se sherbimit, nga punonjesit e sherbimit (sherbim roje fikse ose levizese, patrull, grup te gatshem, operator dhe bodigard) eshte 8 ore.

## K R E U III-te

### Detyrat e Drejtuesit Teknik te Shoqerise

16.Drejtuesi teknik eshte drejtuesi teknik me i larte i shoqerise dhe pergjegjesi ligjor per kete sherbim, i cili ka per detyre.

a) Studjon aktet ligjore e nenligjore per shoqerite e ruajtjes dhe te sigurise fizike si dhe organizon punen per njohjen e tyre nga punonjesit e sherbimit

b) Nenshkruan marreveshjen me personin fizik apo juridik vendas ose te huaj per objektin qe merr ne ruajtje shoqeria, e cila i bashkelidhet kontrates ekonomike.

c) Pergatit ne bashkepunim me personin fizik apo juridik rregulloren e brendeshme te objektit qe merr ne ruajtje.

ç) Organizon dhe drejton kurset e kualifikimit profesional 15 dhe 5 ditor me punonjesit e sherbimit.

d) Perpilon Plan-Dislllokimin me skemat e ruajtjes per çdo objekt ne ruajtje.

e) Organizon sistemin e nderlidhjes dhe percakton mbajtjen e mjeteve speciale ne objektin qe ruan.

f) Mban lidhje te vazhdueshme me specialistin e larte te objekteve me te rendesishme dhe shoqerive private te ruajtjes ne drejtorine e policise qarkut dhe informon per çdo ngjarje qe ndodh ne objekt.

g) Ne çdo tre muaj i paraqet specialistit te objekteve informacion me shkrim, per kryerjen e detyrave te ruajtjes dhe te sigurise fizike dhe problemet qe kane lindur te shoqeruar me statistiken e sherbimit te ruajtjes dhe sigurise fizike te shoqerise.

gj) Harton plane te veçanta per perballimin e ngjarjeve kritike (emergjente) qe mund te ndodhin ne objektet qe ruan dhe siguron.

i) Kontrollon kryerjen e sherbimit per ruajtjen dhe sigurimin e objektit si dhe paisjen me armatim uniforme e dokumentin identifikues te punonjesit te sherbimit.

i) Ben studim per shkallen e sigurise dhe masat mbrojtese te objektit ne ruajtje.

j) Pergatit dokumentacionin e kandidateve per punonjes sherbimi dhe i paraqet ato ne drejtorine e policise qarkut, per marrjen e lejes se ushtrimit te profesionit

k) Nenshkruan kontraten e punes me punonjesit e sherbimit

l) Per organizimin, instruktimin dhe kontrollin e kryerjes se sherbimit cakton pergjegjes sherbimi per çdo turne.

17.Drejtuesi teknik i shoqerise qe ben mbrojtjen e jetes dhe te shendetit personal fizik te shtetasve shqiptar ose te huaj, perveç detyrave te mesipeme ka edhe keto detyra :

a) Organizon, drejton dhe pergatit eskortat e shoqerimit dhe te mbrojtjes se jetes dhe shendetit personal fizik te shtetasve.

b)Perzgjedh punonjesit e sherbimit te pergatitur fizikisht dhe profesionalisht.

c) Percakton menyren e ruajtjes dhe numrin e punonjesve si dhe numrin e automjeteve shoqeruese te eskortes.

ç) Studjon objektin ku do te akomodohet personi fizik qe ka ne ruajtje si dhe percakton rruget e daljes nga objekti ne rast rreziku.

18.Drejtuesi teknik qe ben shoqerimin e vlerave monetare e materiale ose te sendeve te çmuara gjate transportit te tyre, perveç detyrave te mesiperme ka edhe keto detyra :

a) Percakton intenerarin e levizjes se eskortes shoqerimit te vlerave monetare e materiale apo sende te çmuara.

b) Pergatit urdherin e sherbimit, te shoqeruar me liste perkatese e te nenshkruar nga punonjesit e sherbimit qe bejne shoqerimin e vlerave monetare e materiale dhe sendeve te çmuara.

## KREU VI -te

### Detyrat e punonjesit te sherbimit te shoqerise

19.Punonjesi i sherbimit ka pergjegjesi ligjore per objektin qe ruan dhe siguron dhe ka per detyre .

a) Te ruaj dhe siguroj fizikisht objektin e marre ne ruajtje

b) Te kerkoje nga shtetasit zbatimin e rregullave te vendosura per hyrjen e daljen ne objekt ose ne territorin qe ruan dhe siguron si dhe te rregullave te tjera te percaktuara ne rregulloren e brendeshme te objektit

c) Te njohe plan dislokimin, skemen perkatese si dhe sektorin ku kryen sherbim.

ç) Kur pergatitet ose kryhet nje veper penale ne objekt, kryen keto veprime :

- Jep ndihmen e nevojshme te demtuarve
- Merr masa per ndalimin dhe kapjen e autoreve te ngjarjes
- Njofton organet e policise shtetit per ngjarjen e ndodhur
- Ruan vendngjarjen dhe siguron provat ligjore
- Siguron te dhena per deshmitaret e ngjarjes apo autoret
- Njofton drejtuesin teknik te shoqerise per ngjarjen e ndodhur

d) Perdor armen qe ka ne perdorim sipas rasteve dhe kushteve te percaktuara ne ligjin "Per perdorimin e armeve te zjarrit".

e) T'i jap te dhena sa here qe i kerkohet nga punonjesit e policise shtetit qe kane lidhje me kete sherbim.

g) Te kryeje sherbim me uniforme, me ose pa armatim (sipas natyres se sherbimit), paisje e mjete speciale si dhe me dokument identifikues.

gj) Te marre dhe dorezoje sherbimin ne prezence te marresit e dorezuesit dhe ne perfundim informon pergjegjesin e sherbimit apo qendren e drejtimit te sherbimit te shoqerise.

i) Te marri pjese dhe te kryeje kursin e kualifikimit profesional 6 ditor te organizuar nga drejtuesi teknik

j. Te kryej detyrat e percaktuara ne planin e miratuar per situata emergjente.

20.Punonjesi i sherbimit qe ben mbrojtjen e jetes shendetit personal fizik te shtetasve shqipetar apo te huaj, perveç detyrave te mesiperme ka edhe keto detyra .

a)Te qendroje ne çdo kohe e situate prane personit qe ka ne ruajtje

b)Te shoqeroje personin qe ka ne ruajtje gjate levizjes si dhe ne ambjentet e akomodimit.

c) Te shoqeroje personat e jashtem qe kane takim me te, pasi ka marre me pare pelqimin e tij.

e) Te ben ruajtjen dhe sigurimin e automjetit te personit qe ka ne ruajtje

21.Pergjegjesi i sherbimit. te shoqerimit te vlerave monetare e materiale apo sendeve te çmuara gjate transportit, perveç detyrave te mesiperme ka edhe keto detyra :

a) Te pais punonjesit e sherbimit me mjete speciale te nevojshme per kete sherbim.

b) Te marr ne dorezim mjetin e blinduar me te cilin behet levizja e vlerave monetare e materiale apo sendeve te çmuara

c)Te beje kontrollin vizual te automjetit para nisjes ne destinacion.

ç)Te mban kontakt te vazhdushem gjate gjithe intenerarit te levizjes me shoqeruesin e fondeve.

d) Te mbaje nen kontroll te vazhdushem automjetin e blinduar

e) Te hartoje proçes verbalin e dorezimit te vlerave monetare e materiale apo sendeve te çmuara.

d) Te mos lejoj ne mjetet e shoqerimit te vlerave monetare e materiale apo sendeve te çmuara persona te cilet nuk kane lidhje me kete sherbim.

22.Punonjesi i sherbimit me detyre operator kryen keto detyra

a) Te zbatoje urdherat dhe udhezimet e dhena nga drejtuesi teknik per marrjen regjistrimin dhe administrimin e informacioneve sipas rregullave te percaktuara.

b)Te komunikoje dhe mbaje lidhje te vazhdueshme me punonjesit gjate kryerjes se sherbimit.

c) Te evidentcoj informacionet per ngjarjet e ndodhura ne objekt.

ç) Te kontrolloje ne menyre te vazhdushme funksionimin e sistemit te nderlidhjes. dhe ne rast difektesh njofton drejtuesin teknik te shoqerise.

d)T'i raportoj drejtuesit teknik per kryerjen e sherbimit dhe mangesite e raportuara gjate kryerjes se sherbimit.

23 Grup te gatshem quhen 3 apo me shume punonjes sherbimi te planizuar me sherbim per te qendruar te gatshem ne vendin e percaktuar nga drejtuesi teknik, dhe kryen keto detyra :

a)T'u shkoje ne ndihme punonjesit te sherbimit ne objektin qe ruajne dhe siguron ne rastet kur vihet ne rrezik jeta e tij, personelit dhe objekti nga veprime kriminale.

b) Te nderhyj ne rastet e prishjes se rendit dhe te qetesise ne objekt duke bere perforcimin e sherbimit ne kete objekt.

c) Te jap ndihmen e nevojshme personelit ne objekt ne raste situate dhe emergjence.

24.Punonjesi i sherbimit, shoqerues qeni, kryen keto detyra

a) Te mbaje qenin e sherbimit ne gadishmeri dhe t'a perdor ate sipas rregullave te percaktuara per kete sherbim.

b) Te patrulloje dhe te kontrolloje territorin e objektit qe ka ne ruajtje

c) Te mbaje qenin e sherbimit me qafore lidhese e cila te kete mbishkrimin "Qen Sherbimi"

ç)Te marre masa per parandalimin e pasojave qe mund te sjelle perdorimi i qenit te sherbimit

## Kreu VII
## Dispozita te Fundit

25.Per zbatimin e kesaj rregullore ngarkohet drejtoria e policise qarkut dhe drejtuesi teknik i shoqerise se ruajtjes dhe te sigurise fizike.

26.Per kontrollin e zbatimit te kesaj rregullore ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Policise Shtetit.

27.Rregullorja e Ministrit te Rendit Publik Nr.129 date 18.05.1993 "Per Sherbimin e Rojeve Civile", shfuqizohet.

28.Kjo rregullore hyn ne fuqi menjehere

M I N I S T R I

ILIR GJONI